



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË**

Nr. 2315/1 Prot.

Tiranë, më 20.03.2023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1240/1, datë 09.10.2017.

**SHOQËRISË “QERAMIKA APOLLON” SH.P.K
Lagja “Sheq i Madh”, pranë ish-fabrikës së Tullave, Fier.**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “QERAMIKA APOLLON” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1240/1, datë 09.10.2017, për mineralin argjilë, në Objektin “Metalli”, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1281, datë 27.02.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2315, Prot., datë 28.02.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1240/1, datë 09.10.2017, për mineralin argjilë, në Objektin “Metalli”, Bashkia Fier, Qarku Fier, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2022-2023.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1240/1, datë 09.10.2017, për mineralin argjilë, në Objektin “Metalli”, Bashkia Fier, Qarku Fier që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1240/1, datë 09.10.2017, për mineralin argjilë, në Objektivin "Metalli", Bashkia Fier, Qarku Fier, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

